



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrim Evropian

Mbledhja nr. 7

Prishtinë, më 21.07.2021, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Rrezarta Krasniqi, Arbëresh Kryeziu Hyseni, Fridon Lala, Agon Batusha, Arjeta Fejza, Driton Hyseni, Blerta Deliu Kodra, Branisllav Nikoliq dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Shqipe Isufi dhe Ardian Kastrati.

Nga stafi mbikëqyrës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli dhe Safet Beqiri.

Të ftuar: Përfaqësuesit nga shoqëria civile: Venera Aqifi - GIZ, Albana Rexha- Demokraci plus, Arbër Fetahu, - Grupi për Studime Politike dhe Juridike, Arben Kalaja -Instituti Epik, si dhe Visar Xhonbazi nga D4D.

Mbledhjen e kryesoi – Rrezarta Krasniqi, kryetare e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen.

Rendi i ditës:

- 1. Takim i përbashkët me përfaqësues të shoqërisë civile, me qëllim të bashkëpunimit dhe komunikimit në procesin e integrimit evropian të Kosovës**

Kryetarja e hapi takimin dhe falënderoi përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile që ju kanë përgjigjur ftesës për pjesëmarrje në takim. Ajo i njoftoi se ky takim i përbashkët bëhet me qëllim të bashkëpunimit dhe për të siguruar informimin dhe pjesëmarrjen në procesin e integrimit evropian të Kosovës, si dhe mundësinë e organizimit të aktiviteteve të përbashkëta në mënyrë që shoqëria civile të ketë rolin e saj në kuadër të përcjelljes dhe monitorimit të reformave në Kosovë dhe në procesin e përafrimit me Bashkimin Evropian.

Gjithashtu rëndësia e këtij takimi, ka të bëjë me rritjen e bashkëpunimit dhe krijimi i hapësirës për shoqërinë civile për të shpreh këndvështrimin e saj rreth hartimit dhe zbatimit të politikave në kuadër të procesit të integrimit evropian.

Komisioni për Integrim Evropian, shprehet i gatshëm për informimin, konsultimin, komunikimin dhe përfshirjen e shoqërisë civile në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Acosiimit dhe programeve të ndryshme që janë në kuadër të zbatimit të saj.

Siç jeni në dijeni, angazhimi i shoqërisë civile në kuadër të bashkëpunimit me Komisionin, në kuadër të procesit të integrimit evropian të Kosovës mund të bëhet me përfshirjen e përbashkët në aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me kontrollin apo mbikëqyrjen e procesit, zhvillimin e dialogut të përbashkët në lidhje me formulimin e politikave dhe procesin e harmonizimit dhe përafrimit të legjislacionit me Acquis të BE-së. Monitorimin e pavarur të progresit dhe të efekteve për proceset e reformave të ndryshme, e të tjera.

Komunikimi në procesin e integrimit evropian me shoqërisë civile, ka një rëndësi edhe sa i përket dhënies së In putit të saj në Raportin për Vendin.

Ne vazhdim hapi diskutimin.

Arbëresh Kryeziu Hyseni: propozoi që fillimisht të prezantohen secili, se cilën organizatë e përfaqëson dhe të flasin pak për profilin e organizatës, e pastaj t’ i kthehen diskutimit të përbashkët.

Albana Rexha, përfaqësuese nga Demokraci plus: tha se ne punojmë me nivelin qendror dhe nivelin lokal, bëjmë monitorimin e politikave të ndryshme publike të cilat janë në kontest të evropianizimit, jemi duke bërë implementimin e një projekti që po implementohet në disa komuna të Kosovës dhe qëllimi është promovimi i procesit të integrimit dhe njoftimi i zyrtarëve nëpër komuna rreth rolit të tyre që kanë në procesin e integrimit evropian. Se fundi kemi bërë edhe publikimin e një raporti, i cili mat rolin e zyrave në nivel lokal sa i përket integrimit evropian. Kemi rol aktiv edhe në monitorimin e ERA dhe PKZMSA në qeverisjen e mirë, sundimin e ligjit dhe kemi filluar edhe me politikat e ambientit në këtë drejtim.

Arbër Fetahu, përfaqësues nga Grupi për studime juridike dhe politike: tha se si institut merremi me një gamë të fushave të ndryshme, si sundimin e ligjit ku bëjmë monitorimin e gjykatave dhe bëjmë analiza publike dhe hulumtime të ndryshme në sistemin e drejtësisë, kemi fusha tjera si politika e jashtme, integrimet evropiane dhe në këtë drejtim kemi një sërë projektesh, monitorime analiza dhe hulumtime të ndryshme. Më herët dhe tani merret me mbikëqyrjen e zbatimit të MSA-së dhe kemi mbikëqyrje të përhershme të PKZMSA-së dhe me ERA 1 dhe ERA2 dhe procesin e Integrimit evropian e shohim si proces thelbësor për Kosovën dhe rrugën e saj për zhvillim.

Bëjmë mbikëqyrjen e Komisionit Parlamentar për Integrim dhe te Zyra e Kryeministrit, komisioni që merret me Integrimet evropiane, pastaj kemi pas anketa me qytetarët për me marr perceptimin e qytetarëve mbi. IE. E konsideroj këtë takim shumë të nevojshëm për me rritur bashkëpunimin dhe me dhënë kontributin tonë sepse ne, si shoqëri civile, mos të shihemi vetëm si kritikues, por të kontribuojmë aty ku na jepet mundësia sa më shumë që mundemi.

Visar Xhonbazi, përfaqësues nga Instituti për Demokraci dhe Zhvillim “D4D: Në punën tonë e kemi një program të veçantë, i cili merret me dialogun e bashkëpunimit rajonal.

Në kuadër të këtij programi jemi duke financuar edhe një projekt të madh nga fondacioni për shoqëri të hapur i cili titullohet, Rruga dytësore drejtë evropianizimit “. Qëllimi është të ngrehim nivelin profesional të shoqërisë civile dhe të marrim ekspertiza profesionale nga partnerët tanë në BE, në mënyrë që të iniciojmë politika dhe të rekomandojmë politika publike

dhe dokumente të shkurta që do të ishim si rekomandime për institucionet relevante në Kosovë. Kemi zhvilluar dy punime: Integrimi i Kosovës në NATO dhe Bashkëpunimi rajonal. Në pika të shkurta kemi paraqitur opinione publike të qytetarëve për Mini-Shengenin dhe bashkëpunimin rajonal. Ne vazhdojmë të jemi të hapur për çdo lloj bashkëpunimi.

Arben Kalaja: përfaqësues nga Instituti Epik, theksoi se si nisëm i kemi qitur vetes që sa me shumë me i ndihmua shoqërisë sonë, po mundohemi me punuar me të gjitha mekanizmat për me i ndihmuar këtij procesi.

Venera Aqifi, GIZ: Përfaqësoj projektin për mbështetjen e reformave të IE, që nuk është shoqëri civile, por stafi i komisionit e ka parë të arsyeshme të më ftojë sepse e kemi mbështetur Kuvendin dhe punën e Komisionit me vite të tëra. Tani si pjesë e këtij projekti është një projekt i ri i GIZ-it që ka bërë bashkë 3 projekte: Procesin e IE, Reformën juridike dhe Qeverisjen e mirë financiare. Momentalisht me Institutin EPIK kemi mbështet zhvillimin e planit për procesin e IE në Kuvend dhe tani është në pritje të raportimit nga ministrit e linjës dhe agjencitë e tjera. edhe në këtë fazë mbesim prapë të hapur për bashkëpunim nëse është e nevojshme ndihma e projektit të GIZ-it.

Arbëresha Kryeziu Hyseni: falënderoi përfaqësuesit që kanë ardhur edhe pse tha se kanë qenë të ftuar më shumë, por në të ardhmen shpresojmë që të takohemi me secilin përfaqësues që ka në fushëveprimin e saj fushëveprimin që ndërlidhet me IE. Meqenëse Komisioni ynë është për IE synimi ynë është që të bashkëpunojmë me organizatat e juaja në mënyrë që ta dimë se në çfarë fushash konkrete ka secila organizatë e juaja, ekspertiza që mund të na hyjnë neve në punë si komision që ne mund të bazohemi kur do që kemi nevojë për to për t'i çuar përpara këto procese që janë synim i jonë përbashkët. Integrimi Evropian shkon përtej asaj që ne në përditshmëri e dëgjojmë sepse ka shumë fusha që hyjnë brenda saj, siç janë p.sh. politikat tregtare, financiare, ekonomike, shëndetësore dhe çështjet e reformës juridike mjedisore etj. Ne, si Komision, para se ta hartojmë planin e punës e kemi menduar si të rëndësishme që ta diskutojmë mënyrën se si mund të vijmë në kontakt edhe me evrodeputetë që vijnë prej komisioneve të ndryshme dhe të shohim se si mund të ndërtojmë një bashkëpunim në mënyrë që të na ndihmojmë të ecim përpara me këto çështje kurdo që ne të zbatojmë këtë plan dhe kur do që ne të kemi mundësinë, qoftë ti ftojme ata, apo qoftë të dalim në jashtë kufirit dhe t' i takojmë ata jashtë, të kemi mundësinë të flasim bazuar nga ekspertizat që i marrim nga ju e që kanë të bëjnë konkretisht me këto fusha që janë interes i veçantë i IE-së.

Time Kadrijaj: Besoj që kemi me pas bashkëpunim më shumë sepse në këtë situatë që gjendet Kosova është mirë me i pas përkrah organizatat e shoqërisë civile duke kontribuar me rekomandime dhe sugjerime se çka të bëhet në procesin e dialogut dhe cila do të jetë qasja e Kosovës në këtë proces dhe si t' i qasemi liberalizimit të vizave, pasi që Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret, pra të kemi një reagim në kuptimin pozitiv të shoqërisë civile në takimet e ndryshme që keni me organizatat ndërkombëtare. Secila organizatë e shoqërisë civile e ka përkrahur punën e një Komisioni, qoftë me ofrimin e ekspertizave dhe gjatë amendamentimit të ligjeve, shkëmbim të përvojave dhe organizimin e debateve publike për ato ligje me interes për rëndësinë e qytetarëve. Andaj na duhet bashkëpunimi dhe ekspertizat e juaja që i keni bërë për fushat e caktuara i keni publikuar në web- faqet e organizatave tuaja, të na sillni në hard copy te deputetët e linjës së caktuar në mënyrë që t' i diskutojmë bashkërisht në mënyrë që edhe ne të përfitojmë prej ekspertizave tuaja.

Arjeta Fejza: Njëra prej pikave ku vepron komisioni ynë është bashkëpunimi me shtetet rajonale dhe vendet të cilat janë në proces ose kanë dalë nga procesi i integriteteve dhe ne e kemi në fokus me krijuar ura bashkëpunimi me këto vende, por qasja jonë mbetet institucionale. Por ajo që me intereson është se a keni ndonjë bashkëpunim me organizatat e këtyre vendeve dhe a mundemi ne të marrim përvoja nga ta, pasi qëllimin e kemi të përbashkët, t'i koordinojmë aktivitetet që kishin me shërbye në arritjen e qëllimit tonë të përbashkët.

Driton Hyseni: Përfaqësuesja nga organizata D+ e ceku se bëjnë monitorimin e zyrave komunale për integritete evropiane në nivelin lokal, me intereson të dijë se a keni komunikim të përhershëm me këto zyre sepse ne, si komision, kemi ndërmarrë iniciativë që t'i vizitojmë ato zyre dhe t'i inkurajojmë që të bëhet një punë e madhe në implementimin e kritereve sa i përket nivelit lokal në fushën e integritetit. Andaj si e vlerësoni nga këndvështrimi juaj performancën e zyrave komunale për IE?

Agon Batusha: Organizatat e shoqërisë civile gjithmonë e kanë bërë një punë që institucionet nuk e kanë bërë, kanë monitorua ligje dhe kanë përcjellë edhe zbatimin e tyre.

Në bazë të projekteve nganjëherë nga fondet e BE-së organizatat kanë bërë vetë monitorimin e implementimit të ligjeve, që realisht ish dashtë me e bërë shteti. Roli i organizatave në Kosovë dihet dhe ka shumë raporte që i cilësojnë si shtylla të vetë shtet ndërtimit dhe ky rol nuk duhet të venitet, por ta përditësojmë dhe të shohim se si ta vazhdojmë bashkëpunimin edhe me vetë shtetin. Ku në shikim të parë duhen me qenë si opozitë e pushtetit dhe realisht duhet me gjet rrugë bashkëpunimi për IE, sepse kërkon bashkëpunim dhe ekspertizë dhe pikërisht desha për këtë me u ndërlidhur. Kur dëgjojmë politikanët dhe mediat në Kosovë ta merr mendja se IE është vetëm liberalizim i vizave, mirëpo po harrojmë se Kosova mundet me përfutur shumë me shumë prej politikave tjera, që i përmendi Arbëresha, ku janë politikat bujqësore, tregtare, arsimore dhe sociale ku ne, si Kosovë, mund të përfutojmë fonde por për shkak se ne nuk kemi kujdes t'ia amendament ojmë disa ligje, humbim miliona euro. Ne duhet ta gjejmë rrugën se si të bashkëpunojmë më mirë jo vetëm me mbledhje formale, por të takohemi edhe në takime tjera dhe t' i ndajmë përvojat tona dhe idetë tona që t' i çojmë përpara proceset.

Albana Rexha, D+: sqaroi lidhur me projektin ku bëjnë monitorimin e Zyrave komunale për IE dhe tha se ideja ishte me e fuqizuar rolin e këtyre zyrave nëpër të gjitha komunat dhe këto zyra mbesin mekanizmi i vetëm në nivelin lokal që bënë koordinimin e politikave për IE. Ekziston një Rregullore që shpjegon përgjegjësit dhe obligimet e këtyre zyrave dhe ne jemi munduar me vlerësua implementimin e kësaj rregulloreje, jemi në kontakt të vazhdueshëm me të gjithë zyrtarët ku ju kemi dërguar nga një pyetësor, ku i kemi marrë pikëpamjet e tyre lidhur me implementimin e kësaj rregulloreje dhe në fund kemi dalë me disa rekomandime se si mundemi me tepër me i fuqizuar dhe me intensifikua më tepër bashkëpunimin me Zyrën për Integritet Evropian në kuadër të kryeministrit dhe ministrisë për qeverisje lokale.

Arbëresha Kryeziu Hyseni: u ndërlidh në diskutim dhe tha se në kuadër të planit tonë të punës kemi ndërtuar një praktikë, që çdo fund muaj me e vizituar nga një komunë, kryesisht me u njoftuar me punën që bënë Zyra për IE. Kemi qenë në Ferizaj dhe në këtë kuptim mundemi me ndërtuar një bashkëpunim dhe bashkërisht t' i vizitojmë këto zyra meqë në disa komuna dhe në komunën e Gjilanit prej kah vij, kjo zyrë le shumë për të dëshiruar, andaj kisha pasur dëshirë me ditë nëse keni ndonjë raport që tregon se çfarë hapash progresiv kanë bërë këto zyra pas bashkëpunimit që keni bërë me secilin zyrtar që përfaqëson nivelin lokal sepse bazuar në profilet se si i kanë detyrat dhe përgjegjësit nuk bëjnë ndonjë punë të madhe.

Albana Rexha, D+: Hapi parë ka qenë ne me e vlerësuar implementimin e asaj rregulloreje dhe faza e dytë e projektit është takimi që kemi me e bërë në 10 komunat me të mëdha dhe ndokush nga ju duhet me marr pjesë sepse do të jetë në formë të panelit të diskutimit me pjesëmarrës të procesit integrues të çdo niveli dhe ne kemi me prezantuar të gjeturat dhe kemi me provua me qenë prezentë edhe kryetarët e secilës komunë.

Procesi i integritimit i përfshin shumë fusha dhe nuk lidhet gjithçka me procesin e liberalizimit të vizave siç u tha më parë. Ne jemi munduar me luajt rol më aktiv ne takimet që i kemi pasur dhe me treguar për procesin. Ne kemi ekspertizë ne monitorimin e ligjeve të ndryshme dhe strategjive të ndryshme, jemi takuar me disa komisione dhe kemi organizua debate të ndryshme dhe ne mundemi prapë me ju ndihmuar nëse është nevoja. U përmend edhe mundësia e takimit me euro deputet, në të kaluarën kam qenë pjesë e takimeve që i kemi pasur me disa euro deputetë lidhur me liberalizimin e vizave në Parlament dhe Këshillin e BE-së, i kemi kontaktet dhe mundemi me diskutua bashkërisht se çka mundemi me ju ndihmuar lidhur me diplomacinë parlamentare.

Arben Kalaja, EPIK: tha se kam disa pyetje për deputetë, kisha dashtë me e pa qasjen e Komisionit se ku e shihni ju tani me IE, si Kosovë dhe si e shihni rolin e juaj dhe qysh mundemi ne si shoqëri me e konceptualizuar rolin e Kuvendit dhe me pas ndikim në proces, se pari MSA-ja dhe ku e shihni ju rolin e juaj me u sigurua se MSA implementohet dhe me ja çuar mesazhin BE-së se po duam me u bë shtet serioz dhe me tregu se jemi serioz na e marrim secilin rresht në MSA-në dhe e implementojmë.

Hapi tjetër në IE është aplikimi për anëtarësim, sa seriozisht jemi duke e marr këtë si shtet dhe ku është roli i Kuvendit për me u siguruar se ky send ka me ndodhur?

IE seriozisht do të ndodhë kur ne si shoqëri a po duam seriozisht me u bë evropian, a po duam me u bë diçka tjetër, nëse duam të bëhemi evropian atëherë është njëfarë rruge që ne duhet me e ndjek dhe Kuvendi është ai forum ku partitë e ndryshme duhet të thonë se çka mundemi ne, si Kuvend me bë, ju mundeni me bë shumë me iniciuar vërtet atë konsensusin shoqëror dhe deri sa ne nuk e zhvillojmë një mentalitet se ne po duam me mbërri këtu atëherë ne nuk do ta shohim rrugën e IE si transaksion nacional atëherë pjesa e dialogut me BE-në kryhet vetë.

Visar Xhonbazi D4D: Po e shoh se IE dhe liberalizimi i vizave po përdoret si synim, po dua me kundërshtuar këtë sepse liberalizimi i vizave dhe integritimi janë procese krejtësisht të ndara.

Sa i përket pyetjes rreth bashkëpunimit me organizatat në BE dua të potencoj se ne muajin e dytë të muajit nëntor organizata jonë ka një ftesë zyrtare nga instituti Aspen që takohet me deputetët gjerman ne Bundestag dhe deri atëherë ne mund të takohemi dhe të bisedojmë nëse keni ndonjë çështje specifike konkrete që ju konsideroni se ne mund ta parashtrojmë gjatë takimit me deputetët gjerman.

Venera Aqifi, GIZ: Para se të kalojmë te kontaktet me institucionet e Parlamentit Evropian dhe deputetët e Parlamentit gjerman sfida e parë që e kemi është se çka t' ju prezantojmë atyre.

Nuk janë problem takimet me ta, por ka ardhur një situatë ku mundesh me shkuar, por mos me prezantuar asgjë. E para Kuvendi, si organ mbikëqyrës, duhet ta dijë se çka është implementuar dhe çka jo në MSA dhe sfidat ku kanë ngecur proceset. Nuk mjafton vetëm nëse një ministër thirret në raportim dhe ai raporton në përgjithësi dhe më shumë flasin për sfidat ku janë e jo çka po ndodh me procesin. Është koha që Komisioni për integritime mos ta ketë vetëm rolin sipërfaqësor në këtë drejtim, por ta forcoj rolin e raportimit dhe mos ta lejon qeverinë të kaloj aq lehtë.

Roli kyç i këtij komisioni është ta ketë përpara implementimin e Planit për mbikëqyrjen e procesit të integritimit evropian sepse ajo është bazë ku i sheh të gjitha detyrimet që i ka Qeveria e Kosovës ne bazë te Raportit për vendin. Lobimi nuk bëhet vetëm në shtete anëtare të BE-së

i kemi ambasadat këtu dhe ata luajnë një rol me kyç në transmetimin e asaj që doni ju nga politikanët evropianë. Tani është presidenca e Sllovenisë dhe një takim me ambasadorin e Sllovenisë do të ishte i nevojshëm për me pa se ku janë, cilat janë prioritet dhe çka mundemi ne të bëjmë me prioritetet e BE- së, pra ka punë në Kosovë para se të dalim jashtë Kosovës.

Arber Fetahu, GLPS: Te MSA kemi një ekspertizë goxha të theksuar, bëjmë çdo vit një lloj raporti të zgjeruar, por që ka edhe pjesë specifike për zbatimin e MSA-së dhe PKZMSA-së, ku bëhet një lloj matrice dhe janë indikatorët një nga një dhe për vitin 2020 do të dalë shumë shpejt dhe përveç që del në web- faqe mund t' ju dërgojmë edhe me email, po ashtu edhe tek ERA1 dhe ERA 2 GLPS ka përpilua raporte të detajuara, kemi edhe te fusha e zgjerimit kemi publikime se si e kemi parë në qasjen e BE-së te politika e zgjerimit te Ballkani perëndimor, e ne veçanti për Kosovën. Si organizatë kemi takime me përfaqësuesit e korit diplomatik, kemi pas takim me ambasadorin Gjerman ku disa prej diskutimeve ka qenë edhe aspirata e jonë për IE se ku e shohin Kosovën në të ardhmen dhe si mund të lidhim bashkëpunimin më tutje ne këtë drejtim. Sa i përket bashkëpunimit me organizatat tjera, ne fillimisht kemi një projekt me 6 vendet e Ballkanit perëndimor ku bashkëpunojmë jo specifikisht vetëm për IE por edhe për reformën e administratës publike dhe rrjedhimisht edhe aty ka diskutime se si po menaxhohet procesi i Integritit nga këto shtete te Ballkanit perëndimor.

Kemi kontakte direkte edhe me institute ndërkombëtare, kemi bashkëpunim me ASPEN dhe kemi pas takime me Bundestagun Gjerman, pastaj kemi bashkëpunim edhe me disa institute ne Francë që fokus e kanë integrimin e Ballkanit perëndimor. Në këto fusha ne kemi edhe analiza dhe diskutime, dhe ne diskutimet që kemi me i pasur me ta mundemi edhe në Zoom të merrni pjesë si dëgjues për me pa se cila është qasja e tyre. Jemi të interesuar që me krijuar ura bashkëpunimi që janë konkrete me Komisionin e jo vetëm të mbesin vetëm diskutime, por direkt edhe me impute dhe me ndonjë vizitë nëpër institucionet tona apo jashtë.

Visar Xhonbazi, D4D: Para se të shuhet Ministria e Integritit evropian ka bërë një punë të mirë, ka publikuar raporte vjetore dhe dokumentet janë aty, çështje tjetër është se sa janë të përgatitur personat që përfaqësojnë institucionet përkatëse, në anën tjetër pse mendoj që duhet te kemi vëmendje më të madhe ndaj Gjermanisë në këtë fazë është sepse në shtator i kanë zgjedhjet dhe sipas parashikimeve të gjelbërit do të marrin më tepër ulëse dhe do të kemi deputetë të rinj me të cilët duhet të krijojmë ura të bashkëpunimit pasi që Gjermania ka qenë gjithmonë përkrahëse e integritit të Kosovës në BE.

Agon Batusha: tha se z. Kalaja na i bëri disa pyetje për të cilat unë desha me i pyet organizatat sepse ne prezantimin e juaj ju thatë për vlerat që i ka BE, ju si organizatë po mundoheni me i mishëruar te qytetarët e Kosovës. Unë u pajtova në heshtje me atë që ju thatë dhe kjo me nxiti me ju bërë pyetje juve, se a jena duke bërë politika prej pavarësisë e deri sot, përshtypja ime është se niveli lokal dhe niveli qendror i shtetit dhe aktorët tjerë që merren me BE-në kanë bërë politika veç sa me thënë në aspektin e kalkulimit të thjeshtë pa hyrë me shikuar a po i transpozojmë ne vlerat reale që BE i ka, d.m.th a e kemi ne popullin e vetëdijshëm për ato vlera e lëre më politikanet, andaj desha me ju pyet se a keni ndonjë analizë se sa i kemi transpozuar ne vlerat e jo ligjet. Këtu është çështja te vullneti se asgjë nuk bëhet pa vullnet dhe ne besoj se e kemi vullnetin si komision ne tërësi që tani e tutje me i shtyrë këto politika, se ka tash e dy tri vjet po thuajse nuk ecur asnjë ligj apo politikë që ka te bëjë me BE-në. Andaj ne kemi insistuar për një rol aktiv me dalë ne terren dhe me monitorua ligjet. Duke ra në konkluzionin që BE dhe integrimi në BE nuk është alfa dhe omega e krejt jetës shoqërore në Kosovë, por ne duhet me shikuar se sa po i implementojnë ato politika dhe sa po i mishërojnë ato qytetarët tanë. Fundja ne jemi duke kërkuar integrim në BE sepse politikat e BE-së nëse i transpozojmë ne legjislationin e Kosovës e përmirësojnë jetën e qytetarit, nëse mundemi me e bërë këtë pa

u integruar në BE është shumë mirë sepse ky proces në mënyrë automatike të çon drejt integritit në BE.

Arbëresha Kryeziu Hyseni: e vazhdoj kryesimin e takimit pasi që kryetarja paraprakisht kishte pas edhe një takim tjetër. Ne vazhdim tha se po ndërlidhem me diskutimin e z. Kalaja mendoj se keni të drejtë por po ndalem te MSA, janë bërë 5 vite që kemi hyrë ne marrëveshje kontraktuale me BE-në dhe fatkeqësisht ndërrimi i qeverive ka shkaktua sfida dhe probleme në zbatimin e masave dhe kjo ka ndikuar negativisht në performancën ton si shtet. Ne legjislaturën e kaluar ka pasur një ose dy takime të komisionit për mbikëqyrjen e MSA-së që krijohet në kuadër të Kuvendit, ka rënë legjislatura dhe gjithçka ka mbetur aty, por para pak ditësh ky komision është krijuar prapë dhe besoj se ky komision ka me qenë më aktiv se sa ata të kaluarit në mënyrë që me ju qas me seriozisht punës së zbatimit të MSA-së.

Në shtator Komisioni ynë e bënë rishikimin e planit të punës, andaj ju ftoj që secili nga ju nëse keni ndonjë propozim apo ide për ndonjë aktivitet që ju e shihni të nevojshme që ne, si Komision, duhet me e realizua, ju kisha lutur që ta keni parasysh dhe ne jemi të hapur ndaj këtyre propozimeve dhe bashkërisht mundemi me i çuar këto procese përpara.

Jo vetëm ne rishikimin e planit të punës, por jeni të lirë me marr pjesë në çdo aktivitet që ju e konsideroni që ndërlidhet me punën e juaj.

Blerta Deliu Kodra: e konsideron të frytshëm këtë takim për shkak të impaktit që e ka shoqëria civile në proceset integruese, por unë dua ta ngriti shqetësimin edhe për çështje tjera të deputetëve pa prezencën e shoqërisë civile. Jam anëtare e Komisionit ad-hoc për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe kam përcjellë me shqetësim mënyrën se si ne po i zgjedhim anëtarët e bordeve në Kuvend dhe procesi i intervistimit po bëhet i mangët për faktin se mazhoranca po abstenon me i pas përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Tash përmenden disa çështje dhe për këto 5 vite të fundit Kosova ka lidhur marrëveshje kontraktuale me BE-në dhe jemi pjesë e MSA-së dhe ne kur ishim pjesë e pushtetit kemi shfaqur rezervat tona dhe ankesat tona në raport me përmbushjen e obligimeve që ne i kemi për t' u bërë palë kontraktuale me BE-në dhe këtë e kemi thënë në vazhdimësi, por nuk mund të mohohet një proces i gjatë i bashkëpunimit tonë. Ju e dini se ne jemi pjesë e marrëveshjes kontraktuale me BE-në pa u njohur nga 5 shtetet e BE –së dhe Kosova është vendi i parë që e ka një situatë të tillë për shkak të një procesi kaq të rëndësishëm, prandaj dua të çmoj këtë bashkëpunim.

Sot po flasim për një të kaluar të afërt kur ne kemi pasur ndarje edhe ne rrugën tonë evropiane dhe Kosova nuk ka agjendë tjetër dhe e them me plot gojë se ne nuk kemi orientim tjetër përveç orientimit euroatlantik, prandaj është obligim i secilit të punojë që ta forcojë demokracinë e brendshme dhe ky proces të shkojë si duhet. Andaj kisha kërkuar prej shoqërisë civile të jenë edhe më të zëshëm sepse veçanërisht këto dy vite të fundit ne kemi një agjendë të pa qartë lidhur me procesin tonë integruar. Unë kam shprehur rezervat tona kur është zgjedh qeveria e fundit dhe e parafundit që kanë vendosur ta largojnë Ministrinë e Integritit si një ministri e koordinimit për ta barta një proces kaq të rëndësishëm. Ne vitet e fundit ne kemi parë edhe një zbehje të rolit të BE-së në Kosovë pikërisht për shkak të mos arritjes së asaj që kanë pritur qytetarët e Kosovës dhe këto dallime tona kanë agjendat e tyre politike, por interesi i secilit është këtu që ta përmbushim këtë agjendë dhe që këta qytetarë të pajisen me viza dhe ta marrin të drejtën e tyre.

Agon Batusha: Unë ndoshta jam keqkuptuar gjatë diskutimit tim, por atë çka kam deshtë me thënë është se mos të implementojmë në ligje vetëm që po i kërkon BE për hir te integritit, por t'i implementojmë që të ju lehtësojmë jetën qytetarëve. Ekzistojnë shumë ligje dhe rregullore që duhet me i transpozuar dhe këtë duhet ta bëjmë për hir të qytetarëve dhe jo vetëm

se duhet me ja bërë tik se po na duhet për integrim. Kjo ishte ajo Alfa dhe omega që desha me thënë.

Fridon Lala: Ne, si Komision dhe legjislaturë e re e Parlamentit, jemi të interesuar t'i krijojmë platformat të cilat ju krijojnë shoqërisë civile mundësinë dhe hapësirën e nevojshme që ata të ofrojnë ekspertizën e tyre në fusha të caktuara të cilat kanë ndikim në të mirën e përgjithshme të Kosovës. Nëse ne aspirojmë në vlera evropiane e dimë që sot brenda unionit, kemi Hungarinë dhe Poloninë dhe në anën tjetër kemi Gjermaninë, Danimarkën, Norvegjinë dhe shtet tjera mbi të cilat vlera të BE-së ne po aspirojmë të shkojmë. Besoj që ky diskursi të ndahemi ne dhe Evropa po besoj që është hapi i parë që ne duhet ta ndryshojmë dhe që e ceku z. Kalaja e vërejmë se sa abstraktë është nëse flasim me një Aziatik, apo Afrikan apo Amerikan sepse ne jemi ne Evropë. Sa i përket progresit të Kosovës që i përket prapë pyetjes se z. Kalaja, rasti i Kosovës është pak specifik për shkak se kemi një proces të dialogut i cili paraprin procesin e integritetit, edhe pse ne kemi bërë hapa progresiv dhe i kemi përmbush të gjitha kriteret e BE-së por prapë nëse kemi me ngec në procesin e dialogut ka me qenë sfidë e madhe që ne një ditë të anëtarësohemi në BE. Kur flasim për progresin e Kosovës është mirë të flasim edhe në aspektin regjional, për shkak se e dimë se prej 2008 pas anëtarësimit të shteteve të fundit atëherë BE-ja e ka pas fokusin ka gadishulli i Ballkanit, si tërësi e shteteve të zgjerimit të procesit të BE-së. Kam pasur rastin të lexoj raporte të shteteve të rajonit në Kosovë, ku euro-skepticizmi është shumë ne rritje si pasojë e alternativave investive.

Ju ceket se keni bërë shumë hulumtime dhe anketa, andaj pyes se a ka raporte të tilla nga ana e shoqërisë civile që e matin euro-skepticizmin në Kosovë, sepse besoj se neglizhenca apo presioni publik i popullatës apo sentimentet e përgjithshme ndikojnë në zbehjen apo në shtyrjen përpara të agjendave shtetërore.

Venera Aqifi: E kemi bërë një analizë përmes Hugo consulting për nevojat e projektit e cila i pyet qytetarët e Kosovës për procesin e IE dhe procesin e MSA-së, pra me këtë e vërejmë se nuk ka rënie të vullnetit të qytetarëve në anëtarësimin në BE dhe janë optimist për procesin e Integriteteve evropiane.

Time Kadrijaj: Jemi vendi i vetëm që e festojmë ditën e Evropës pa qenë pjesë e saj. Ne përveç amendamentimit dhe miratimit të ligjeve e kemi për obligim edhe implementimin e tyre, një ligj për sesion. Unë jam deputete për disa mandate dhe shpesh herë gjatë monitorimit kemi parë se nuk po zbatohen ligjet dhe komisionet relevante kanë kërkuar plotësim ndryshim apo amendamentim të serishëm të ligjeve për shkak të shumë pikave që nuk janë zbatuar. Edhe ne, si komision, duhet me filluar me monitorimin e ligjeve që janë në fushëveprimtarinë tonë. Ndërsa sa i përket Komisionit për MSA-në unë kam qenë pjesë e atij komisioni, të them të drejtën është formal sepse paraprakisht përcaktohen temat për çka ka me u diskutuar dhe ne si delegacion i Kosovës kemi dalë me temat të cilat i kemi përgatitur dhe e kemi prezantuar. Të njëjtat tema prezantohen edhe nga eurodeputetet dhe në fund krijohet njëfarë raporti që dilet me rekomandime, por ka ndodhur për shkak të disa mospajtimeve që kanë qenë nga pala kosovare nga takimi nuk janë aprovuar rekomandimet, sepse duhen 2/3 e votave nga të dyja komisionet. Ju falënderoj dhe kisha dashtë me pas kontakt direkt me ju dhe me bashkëpunuar sepse është në të mirën e përgjithshme.

Arjeta Fejza: Falënderoj për përgjigjen e dhënë nga përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe arsyeja se pse e ngrita atë pyetje është se jam për herë të parë në këtë komision dhe gradualisht po informohemi me proceset që janë brenda institucioneve dhe të cilat gjithsesi nuk janë të qastme për të gjithë, e që sidomos nuk janë të fushës. Ju e vërejtjet nga të gjithë parafolësit një gatishmëri dhe vullnet të shtuar për me u bë pjesë e një procesi i cili do të punojë me intensitet

më te shtuar. Besoj që ky takim është një nismë në raport me atë se çka ne po pretendojmë të bashkëpunojmë dhe se si ne po mendojmë t' i qasemi raportit të përgjithshëm që do ta kemi ne me IE. Na pret një rrugë e gjatë e bashkëpunimit dhe gatishmëria është dy paleshe dhe besoj se ka me ndikuar edhe ne rezultate konkrete.

Arbëresha Hyseni Kryeziu tha, kam një sqarim me tepër për hir të opinionit sepse nuk desha me e shfrytëzua pozicionin e kryesueses së komisionit pasi që kryetarja pati një takim paraprak te cilin nuk mundi me lanë, me u ndërlidh me diskutimin e deputetes Blerta lidhur me procesin e intervistimit për Komisionin e pa varur për media, nuk po pajtohem me atë që u tha se mazhoranca ka abstenuar ne pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile në monitorim të procesit, sepse sa e di unë personalisht kamë qenë anëtare e këtij komisioni në legjislaturën e kaluar dhe nuk jam tash, por goxha shumë e përcjelli punën e këtij komisioni se ka shumë çështje brenda këtij komisioni që përkojnë me profilin tim dhe më interesojnë.

Sa e di unë asnjë përfaqësues i organizatës civile nuk ka shpreh interesim me marr pjesë ne procesin e intervistimit për anëtar të bordit te KPM-ës dhe si rrjedhojë kjo nuk do të thotë se ka qenë mos gatishmëri e mazhorances për të marrë pjesë ata aty. Pasi kemi përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile këtu, ju bëjë thirrje që në secilin do proces brenda Kuvendit që mendoni se duhet me e monitoruar, monitorojeni sepse fundja po thirrremi ne transparencë dhe nuk duhet me e bojkotua një gjë te tillë.

Albana Rexha e përmendi z. Batusha me herët dhe kolegu nga shoqëria civile se pak a shumë po pajtohem ne përgjithësi që qasja e qeverive të kaluara ka qenë kryesisht e orientuar me tepër ka adoptimi i ligjeve dhe strategjive sepse ka qenë shumë ma e lehtë për me u vlerësua si pozitive arritja e atyre iniciativave, mendoj se detyrë kryesore e komisionit tuaj është me tepër me u përqëndruar ne vlerësimin e zbatimit të ligjeve të caktuara dhe për mes komisionit me u munduar me arrit një konsensus mbarë kombëtar sa i përket avancimit te agjendës evropiane për shkak të diversitetit politik që e ka.

Blerta Kodra Deliu: Kam qenë anëtare e komisionit të pavarur të mediave ad-hoc dhe këtu kemi një reagim të Federatës së Gazetarëve të Kosovës dhe reagim të shoqërisë civile për përjashtim nga ky proces, sepse është mbajtur sekret dhe ky nuk është shembull i vetëm. Ne, siç e dini, kemi një marrëveshje bashkëpunimi në mes Ambasadës Britanike dhe Kuvendit të Kosovës të firmosur nga Kryetari Veseli aso kohe dhe jemi marrë vesh që në proceset e përzgjedhjes të anëtarëve të bordeve në institucione të rëndësishme t' i kemi natyrisht partnerët tanë dhe shoqërinë civile. Jemi dëshmitarë se kemi pasur përjashtim edhe të Ambasadës Britanike ne proceset e selektimit të kandidatëve nëpër borde të rëndësishme. Kuptoj që takimi i sotëm është vetëm koordinues, por meqë kemi përfaqësuesit e shoqërisë civile unë dua edhe një herë ta adresoj shqetësimin se shoqëria civile nuk guxon të përjashtohet nga asnjë proces dhe mos te na evidentohet nëpër Raportet e progresit si sfidë, sepse është e rëndësishme që procesi të jetë transparent dhe të jetë i përfshirë me të gjithë aktorët për të pas një rezultat të rëndësishëm.

Arbëresha Kryeziu Hyseni tha, sa e di unë shoqëria civile nuk ftohet me marr pjesë në monitorim, por ata duhet të bëjnë kërkesë vetë për ta përcjellë një proces te tillë dhe e di se nuk ka pasur kërkesë zyrtare dhe po të kishte pas interesim asgjë nuk do i kishte ndalur me marr pjesë në monitorim të atij procesi.

Në fund falënderoj shumë pjesëmarrësit në takim dhe uroj që ky takim mos të jetë i natyrës formale sa për te thënë se e përmbushëm një aktivitet tonin, por besoj shumë që kemi me ndërtuar një bashkëpunim të sinqertë me njëri- tjetrin, sepse ne kemi shumë nevojë për këto

ekspertiza tuaja në mënyrë që të arrijmë t' i qojmë përpara proceset e rëndësishme që ndoshta kanë ngecur dhe nuk kemi kohë të presim më dhe duhet të bashkohemi për të ecur përpara.

Takimi përfundoi në orën 12:35.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetare e Komisionit,

Rrezarta Krasniqi